



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:166774
Datë: 30.05.2024
Numri i dokumentit: 05758187

CAP.nr.1300/23

GJYKATA E APELIT TË KOSOVËS NË PRISHTINË, gjyqtari individual Arsim Hamzaj, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit të përmbarimit Pro Credit Bank, me seli në Prishtinë, kundër debitorëve të përmbarimit S.O nga P,,,, i përfaqësuar nga av. F.M nga P,,,,, Xh.O nga P,,,, dhe H.O nga P,,,,, për shkak të borxhit në emër të kthimit të kredisë, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit S.O, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - departamenti i përgjithshëm, PPP.nr.532/2016, të datës 28.02.2017, me datën **27.05.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e debitorit S.O nga P,,,, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - departamenti i përgjithshëm PPP.nr.532/2016, i datës 28.02.2017, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin PPP.nr.532/2016, të datës 28.02.2017 e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit S.O nga P,,,, i ushtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i tij av. F.M nga P,,,,, më datë 24.06.2016, kundër Urdhrit për lejimin e përmbarimit P.nr.188/16 të datës 10.06.2016, të lejuar nga Përmbaruesi Privat, në Prishtinë,

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor debitori ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të *konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale*, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën e debitorit si të bazuar dhe aktvendimin e atakuar ta prishë, lëndën ta kthej në rivendosje ashtu që propozimin për lejimin e përmbarimit ta refuzon në tersi si të pa bazuar.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar i autorizuari i kreditorit me propozim bërë Gjykatës së Apelit që ankesën e debitorit ta refuzojë si të pabazuar ndërsa aktvendimin e ankimuar ta vërtetojë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

- Ankesa e debitorit, është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori Pro Credit Bank, me seli në Prishtinë me datën 20.05.2016, ka paraqitur propozim për përmbartim, ndaj debitorëve S.O nga P,,,, i përfaqësuar nga av. F.M nga P,,,,, Xh.O nga P,,,, dhe H.O nga P,,,,, në bazë të Marrëveshjes mbi kredinë nr.,,-....., e datës 04.12.2006 dhe Marrëveshja mbi Hipotekën nr. ,/,,. Përmbartuesi Privat D.B i emëruar në territorin e Gjykatës Themelore në P,, me datën 10.06.2016, ka nxjerrë Urdhrin P.Nr.188/16, me të cilin ka lejuar përmbartimin. Kundër aktvendimit për caktimin e përmbartimit, debitori me datën 24.06.2016, ka paraqitur prapësim me të cilin ka kërkuar që të aprovohet prapësimi i debitorit, duke propozuar që aktvendimi i atakuar të anulohet si i pa bazë, dhe i palejuar. Kreditori me datë 28.06.2016, ka parashtruar përgjigje në prapësim.

Duke vendosur mbi prapësimin e debitorit, gjykata e shkallës së parë ka nxjerr aktvendimin e ankimuar PPP.Nr.532/16, të datës 28.02.2017, me të cilën e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit dhe ka vendosur sikurse në dispozitiv të të njëjtit. Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se pas shqyrtimit të prapësimin të debitorit, si dhe shikimit dhe vlerësimit të shkresave tjera të lëndës, ka gjetur se debitori nuk ka ofruar prova për të argumentuar se ekziston ndonjëri nga shkaqet e parapara në nenin 71 par. 1 pika 1 deri 12 të LPP-së në të cilat bazohet prapësimi i palës. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se Marrëveshjet kreditore, marrëveshja mbi hipotekën dhe aktvendimi, të gjitha me numra dhe data të cekura më lartë paraqesin dokumente përmbartuese në bazë të nenit 22 par.1.2 dhe përbëjnë bazë juridike për caktimin e përmbartimit, ngase i plotësojnë kushtet ligjore nga neni 27 të LPP-së, për të qenë i përmbartueshëm dhe i përshtatshëm për përmbartim. Andaj, nga arsyet e paraqitura, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbartimit e të cilat janë paraparë në nenin 71 të LPP-së.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës të ofruar nga palët ndërgjyqëse, ka vendosur drejtë kur prapësimin e debitorit e ka refuzuar si të pabazuar duke dhënë arsye përkatëse në pjesën arsyetuese të aktvendimit të ankimuar. Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të

dispozitive të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit pretendimet e debitorit të përmbartimit se *Dokumenti i lejuar për përmbartim nuk e ka fuqinë e dokumentit të ekzekutueshëm konformë nenit 24.1 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore ngase dokumenti i lejuar nuk është Aktgjykim i plotëfushqishëm, as Ujdi Gjyqësore dhe nuk është as dokument në procedurën administrative me titull ekzekutiv*. Këto pretendime ankimore nuk u aprovuan për shkak se Marrëveshja mbi Hipotekën nr.VR.nr.,,,,/,,,e datës 30.11.2006, aktvendimi mbi regjistrimin e hipotekës me nr. protokollit: ,,,-,-,-,,,i datës 01.12.2006, janë dokumente përmbartimore, ngase me nenin 22, par.1, nën par.1.7 të LPP-së përcaktohet se “ *Dokumente përmbartuese janë: 1.7. kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit*” dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbartimit sipas nenit 21 të LPP-së, i cili përcakton se: “*Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër*”. Marrëveshja mbi hipotekën nr.VR.nr.,,,,/,,,e datës 30.11.2006, siguron të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja mbi Kredinë për Individë A-,,, të datës 01.12.2006.

Tutje, nuk qëndrojnë as pretendimet e debitorit se *borxhi i kërkuar është parashkruar në kuptim të nenit 352 të LMD-së ngase Kërkesat Reciproke nga Kontratat për Kredi parashkruhen në afat prej 5 viteve*, për faktin se sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit me dispozitën e nenit 349 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve NR. 04/L-077 është përcaktuar se “*Kur të ketë kaluar afati i parashkrimit, kreditori kërkesa e të cilit është e siguar me peng ose me hipotekë, mund të paguhet vetëm nga sendi i ngarkuar, në qoftë se e mban në dorë apo në qoftë se e drejta e tij është regjistruar në regjistrat publikë*”. Në këtë rast kreditori kërkesën e tij e ka të siguar me pronën e lënë në hipotekë në bazë të Marrëveshjes mbi Hipotekën nr.VR.nr.,,,,/,,,e datës 30.11.2006, e cila është e regjistruar në regjistrat publik në bazë të aktvendimi mbi regjistrimin e hipotekës me nr. protokollit: ,,,-,-,-,,,i datës 01.12.2006, po ashtu në bazë të nenit 132 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore Nr. 03/L-154 lidhur me kërkesat e siguruara thuhet “*Një e drejtë sendore e sigurimit mund të ushtrohet edhe atëherë, kur kërkesa e siguar është parashkruar*”.

Lidhur me pretendimin e kreditorit në përgjigje në ankesë se *fillimisht e kundërshtoj ankesën e ushtruar na ana e debitorit duke kërkuar që të shikohet afatshmëria e ushtrimit të kësaj ankese nëse është ushtruar brenda afatit* - Gjykata e Apelit pas analizimit të shkresave të lëndës konstaton se debitori, përkatësisht përfaqësuesi i autorizuar i debitorit aktvendimin PPP.Nr.532/16 të datës 28.02.2017 e ka pranuar me datën 21.07.2023 ndërsa ankesa është dorëzuar në gjykatë me datën 28.07.2023 brenda fatit kohorë të paraparë me dispozita ligjore konkretisht në ditën e 7-të.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par.2 të LPP, me të cilën është paraparë se *”në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”*.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.1300/23, me datën 27.05.2024

Gjyqtari
Arsim Hamzaj